



Funded by
the European Union

Përvojat e Personave Queer në Marrjen e Shërbimeve nga Profesionistët e Shëndetit Mendor dhe Punës Sociale

2024

Implementuar nga:



CEL
CENTRE FOR EQUALITY
AND LIBERTY IN KOSOVA

QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETET LGBT NË KOSOVË (CEL)

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESE E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

CEL. Tel: +383 49 701 499
e-mail: info@cel-ks.org
web-page: www.cel-ks.org

Klauzola e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Bashkimi Europian. Përmbatja e tij është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Përvojat e Personave Queer në Marrjen e Shërbimeve nga
Profesionistët e Shëndetit Mendor dhe Punës Sociale

Hulumtues

Erëza Shaqiri & Endrita Lakna

Mentore

Rita Selimi

Universiteti i Prishtinës,
Fakulteti Filozofik,
Departamenti i Punës Sociale
dhjetor, 2024

Abstrakti

Komunitetet LGBTI+ vazhdon të përballet me diskriminim të përhershëm në shumë aspekte të jetës, duke përfshirë mjediset sociale dhe institucionale. Ky studim fokusohet në përvojat e individëve queer në Kosovë, duke analizuar pengesat dhe mundësitë për përmirësim në aksesin ndaj këtyre shërbimeve. Në një mjedis shpesh të karakterizuar nga qëndrime konservatore, individët LGBTI+ përballen me sfida specifike, si stigmën sociale dhe mungesën e mbështetjes së personalizuar, që ndikon negativisht në mirëqenien e tyre mendore dhe sociale. Studimi identifikon barrierat të rëndësishme, përfshirë mungesën e ndjeshmërisë dhe përgatitjes së profesionistëve për të trajtuar çështjet që lidhen me identitetin gjinor dhe orientimin seksual. Për më tepër, kufizimet në burime dhe hapësira mbështetëse reduktojnë mundësitë për individët queer për të marrë ndihmën e duhur. Këto sfida theksojnë nevojën për krijimin e programeve gjithëpërfshirëse, përmirësimin e trajnimeve profesionale dhe zhvillimin e rrjeteve mbështetëse që fuqizojnë komunitetet queer. Ky studim thekson rëndësinë e një qasjeje të strukturuar dhe të përshtatur për ofrimin e shërbimeve sociale dhe të shëndetit mendor. Ai synon të nxisë krijimin e një mjedisi mbështetës që respekton diversitetin dhe përfshirjen, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës për individët queer në Kosovë.

Fjalët kyçe: *shëndet mendor, LGBTI+, mirëqenie, përfshirje kulturore, shërbime sociale, Kosovë, individët queer, psikologe, punëtorë social, shërbime të shëndetit mendor.*

Hyrje

Personat LGBTI+ përjetojnë vështirësi dhe sfida me shëndetin mendor. Rezultatet e studimit të Moagi et al. (2021) treguan se komunitetet LGBTI+ përjetojnë shqetësime të rëndësishme emocionale dhe sfida të shëndetit mendor si rezultat i stigmatizimit, viktimizimit, diskriminimit dhe barrierave për t'u qasur shërbimeve të kujdesit të shëndetit mendor. Pak studime janë kryer në këtë drejtim në kontekstin Kosovar. Studimet e pakta që janë bërë në Kosovë tregojnë se qasja e institucioneve ndaj personave LGBTI+ nuk është e përshtatshme (Sopa, 2019). Për këtë arsye një studim në eksplorimin e përvojave të vet personave është me vlerë kështu edhe duke pasuruar literaturën në kontekstin Kosovar mbi këtë temë. Rritja e vetëdijësimit, kompetencave dhe informacionit të profesionistët e shëndetit mendor mbi çështjet LGBTI+ është më se e nevojshme. Rezultatet e studimit mund potencialisht të kenë ndikim në praktikën e shërbimeve të shëndetit mendor, kështu duke arritur në trajtim dhe ofrim të shërbimeve më të mira të personave queer, ndryshimin e praktikave aktuale dhe ofrimin e mbështetjes adekuate.

Qëllimi i këtij studimi është të eksploroj përvojat e personave LGBTI+, duke vënë theks të vecantë në dëmin, vështirësitë, keqtrajtimin dhe diskriminimin e shkaktuar nga profesionistët e fushës së shëndetit mendor. Për më tepër, synohet të kuptohen barrierat dhe sfidat në kërkimin dhe marrjen e shërbimeve të shëndetit mendor duke shqyrtuar faktorët përkatës. Pyetja kërkimore e këtij studimi është: Cilat janë përvojat e personave queer në marrjen e shërbimeve nga profesionistët e shëndetit mendor dhe punonjësve social?

Definimi i variablave

Queer është definuar si term ombrellë për njerëzit që nuk janë heteroseksualë ose nuk janë cisgjnorë.

Profesionist i shëndetit mendor është një person i trajnuar dhe i licencuar që ofron mbështetje, vlerësim dhe trajtim për çështje emocionale, psikologjike dhe të sjelljes.

Punëtor social u definua si një individ, roli i të cilit është të ndihmojë njerëzit që përballen me disavantazhe sociale ose sfida personale në një fushë të caktuar.

Shqyrtimi i Literaturës

Zhvillimet e fundit, si në kuptimin dhe pranimin publik ashtu edhe në njohuritë shkencore, nxjerrin në pah sfidat e shëndetit mendor me të cilat përballen të rinjtë queer. Në të njëjtën kohë mbeten boshllëqe kritike në adresimin e nevojave të tyre përmes politikave dhe kujdesit klinik efektiv (Russell & Fish, 2016). Studimet zbulojnë se të rinjtë queer përjetojnë shkallë më të larta të shqetësimit emocional, simptomave të çrregullimit të humorit dhe ankthit, vetëdëmtimit, ideve vetëvrasëse dhe sjelljes vetëvrasëse në krahasim me të rinjtë heteroseksualë (Eskin et al., 2005; Fergusson et al., 2005; Fleming et al., 2007; et al., 2011, cituar në Russell & Fish, 2016). Për më tepër të rinjtë queer raportojnë nivele disproporcionale të larta në përdorimin e substancave kur krahasohen me bashkëmoshatarët e tyre heteroseksualë (Institute of Medicine, 2011; Marshal et al., 2011; Marshal et al., 2008, cituar në Choukas-Bradley & Thoma, 2022). Shëndeti mendor ndikohet edhe nga mungesa e mjediseve gjithëpërfshirëse, ku adoleshentët queer përjetojnë nivele më të larta viktimizimi dhe rezultate më të dobëta të shëndetit mendor (Choukas-Bradley & Thoma, 2022).

Mungesa e qasjes në shërbimet gjithëpërfshirëse të

shëndetit mendor mund të jetë një faktor kontribues në nivelet e larta të depresionit, vetëvrasjes dhe shqetësimeve të tjera të shëndetit mendor midis këtyre popullatave (Steele et al., 2016). Vështirësia për t'u qasur në shërbime të shëndetit mendor gjithëpërfshirëse, të ndjeshme kulturore dhe efektive mund të jetë një faktor kontribues në nivelet e larta të depresionit, rrezikut të vetëvrasjes dhe shqetësimeve të tjera të shëndetit mendor (Gnan et al., 2019). Pavarësisht nevojës së qartë për shërbime të shëndetit mendor, individët queer përballen me pengesa të shumta. Pakicat seksuale, veçanërisht gratë dhe individët transgjjinorë, raportohet se kanë gjasa më të larta për të kërkuar kujdes shëndetësor mendor dhe për t'u përballur me trajtim diskriminues, duke përfshirë refuzimin, keqtrajtimin e shqetësimeve të shëndetit mendor dhe refuzimin e përdorimit të përemrave të duhur (Steele et al., 2016). Komuniteti transgjjinor vazhdon të jetë një nga grupet më të neglizhuara të pakicave seksuale dhe gjinore brenda kujdesit shëndetësor, pasi ata ndeshen me barriera që i privojnë nga mundësitë, dinjiteti dhe respekti që ka një efekt të dëmshëm në mirëqenien e tyre mendore (Bockting et al., 2020 Winter et al., 2016, cituar në Rees et al., 2020).

Pavarësisht nevojës së qartë për shërbime të shëndetit mendor, individët queer përballen me pengesa të shumta për t'u qasur në to. Ojeda-Leitner dhe Lewis (2019) shkruajnë se shumë pacientë LGBT kanë frikë të komunikojnë me profesionist për shëndetin e tyre mendor për shkak të kërcënimeve të stereotipeve. Për më tepër kërcënimet stereotipe mund të ndikojnë në marrëdhënien që një klient mund të ketë me shërbyesin e tyre duke kontribuar në shmangien e shërbimeve, pengimin e komunikimit ndërmjet klientit dhe profesionistit dhe mosrespektimin e planit të trajtimit (Ojeda-Leitner & Lewis 2019). Stigma është një barrier tjetër shumë vështirësuese e situates. Stigma u përshkrua si e

lidhur me përdorimin e gjuhës heteronormative dhe pritshmëritë cis normative të profesionistëve për pamjen dhe sjelljen (Rees et al., 2020). Homofobia, bifobia dhe transfobia, së bashku me monoseksizmin dhe paragjykimet heteroseksiste, u përjetuan shpesh nga individët LGBTI+ kur angazhoheshin me shërbimet e shëndetit mendor (Rees et al., 2020). Shpesh personat queer përshkruan se ndiheshin të injoruar ose të keqtrajtuar për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor, duke heshtur nga frika kur përdorin shërbimet e shëndetit mendor (Rees et al., 2020).

Faktorë tjerë që ndikojnë në rezultimin e situatave të padobishme shpesh përfshijnë mungesën e kompetencës kulturore të terapistëve, keqkuptimet e shqetësimeve nga individët queer dhe paragjykimet e paqëllimshme, të cilat mund të pengojnë përparimin terapeutik dhe mirëqenien e klientit (APA PsycNet, n.d.). Mungesa e njohurive të demonstruara nga stafi shpesh i bënte individët të ndiheshin të cenueshëm dhe të pashpresë pasi orientimi i tyre seksual ose identiteti gjinor nuk pranohej, duke çuar në atë që ata mendonin se ishte praktikë e pandjeshme nga ana kulturore (Rees et al., 2020). Poashtu, raportohet se disa profesionist bënë pyetje të cilat nuk kishin të bënin me shëndet mendor, duke i bërë personat queer të ndiheshin se po ofronin edukim gjatë këtyre ndërveprimeve (Rees et al., 2020). Këto përvoja qojnë edhe në mbajtjen e fshehtë të identitetit queer. Arsyet për moszbulimin e identitetit queer në studimin Rossman et al. (2017) përfshinin ofruesit që nuk pyesnin për identitetin, stigmën e brendshme dhe besimin se shëndeti dhe identiteti LGBTI+ nuk kanë lidhje.

Ofruesit e kujdesit mendor afatgjatë përballen me barriera serioze për mbështetjen e të moshuarve LGBTI, të tilla si trajnimet e pamjaftueshme për çështjet specifike queer dhe stigmën në ambientet e kujdesit, që kufizojnë efektivitetin e kujdesit (Smith et al., 2018). Kjo mungesë përgatitjeje shpesh

bën që personat LGBTI+ të hezitojnë të zbulojnë identitetin e tyre, gjë që ndikon negativisht në qasjen e tyre ndaj mbështetjes cilësore të shëndetit mendor (Smith et al., 2018). Kujdesi efektiv i konsideron njerëzit në kontekstin e identitetit të tyre gjinor dhe preferencave seksuale, si dhe një sërë faktorësh të tjerë të cilët ndërveprojnë me gjininë dhe ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve (McCann & Sharek, 2013).

Duhet marrë parasysh se brenda komuniteteve ekziston një ndërthurje faktorësh të ndryshëm që ndikojnë në qasjen e individëve në shërbimeve. Përveç identitetit queer, faktorë të tjerë si varfëria dhe përkatësia etnike luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e barrierave. Këta faktorë të ndërthurur krijojnë sfida të shumta për individët queer, duke theksuar nevojën për një qasje të ndjeshme dhe të personalizuar në shërbimet mbështetëse. Gjetjet theksojnë se ndërsa barrierat për qasjen në shërbim ekzistojnë qartë për personat queer me të ardhura të ulëta, thjesht rritja e qasjes nuk do të jetë e mjaftueshme për të krijuar një sistem të barabartë të shëndetit mendor (Ross et al., 2018). Edhe pas aksesit, shërbimet e disponueshme të shëndetit mendor janë të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat specifike të personave queer që jetojnë në varfëri, kryesisht për shkak të mungesës së njohurive dhe gatishmërisë së ofruesve të shërbimeve për të adresuar çështjet që lidhen me njerëzit queer, varfërinë dhe ndërthurjen e këtyre përvojave (Ross et al., 2018)

Studentët në profesionet shëndetësore, duke përfshirë punën sociale, shpesh ndihen të papërgatitur për praktikën profesionale me personat LGBTI+ (Dillon et al., 2004, cituar në Craig et al., 2014) Studentët e papërgatitur bëhen punonjës socialë, sjelljet profesionale të të cilëve mund të pasqyrojnë mungesën e njohurive në lidhje me popullsinë queer, e cila më pas mund të pengojë kompetencën e tyre në praktikë

(Bassett dhe Day, 2003, cituar në Craig et al., 2014). Punonjësit socialë raportojnë se nuk mendojnë se kanë marrë njohuri dhe kompetencë adekuate gjatë trajnimit të tyre për punën sociale për të punuar me klientët LGBTI+ (Logie, Bridge, & Bridge, 2007, cituar në Lennon-Dearing & Delavega, 2015). Studimi i Dentato et al. (2015) nxjerr në pah një hendek signifikant në gatishmërinë e studentëve të punës sociale për të adresuar nevojat e individëve LGBT të prekur nga përdorimi i substancave. Në veçanti, një pjesë e konsiderueshme e studentëve ndiheshin më pak kompetentë për të adresuar nevojat e individëve transgjinjorë në krahasim me individët LGB (Dentato et al., 2017).

Qëndrimet negative dhe njohuritë e pamjaftueshme rreth çështjeve LGBTI+ paraqesin pengesa kryesore për qasjen e shëndetit mendor për individët LGBTI+, duke rrënjosur më tej pabarazitë në kujdesin shëndetësor (Cruciani et al., 2024). Ka boshllëqe të dukshme në njohuritë dhe aftësitë e ofruesve të kujdesit shëndetësor, me shumë ndjenja raportimi të pamjaftueshmërisë, kompetencë të pamjaftueshme dhe gatishmëri të ulët për të adresuar nevojat LGBTI+. Mundësitë e kufizuara të trajnimit dhe një interes i fortë për arsimim të mëtejshëm mbi këto tema nxjerrin në pah nevojën urgjente për të përmirësuar gjithëpërfshirjen dhe kompetencën kulturore brenda organizatave të kujdesit shëndetësor dhe programeve arsimore (Cruciani et al., 2024).

Metodologjia

Mostra

Mostra e këtij studimit ishte e qëllimshme, duke përdorur teknikën e topit të borës në studim u përfshin 7 persona që i përkisnin komuniteteve LGBTI+. Përveç kësaj një kriter tjetër për përfshirje ishte marrja e shërbimeve nga profesionistët e shëndetit mendor apo punonjësit social. Nuk kishte kritere që personat të kenë përvojë me të dy llojet e profesionistëve dhe janë pranuar pjesëmarrës që kanë pasur përvoja vetem me njërin nga ta. Moshë e pjesëmarrësve varionte nga 21 deri në 27 vjeçarë.

Metoda

Ky studim përdori metodën kualitative duke përdorur intervista të gjysmë strukturuara për të eksploruar përvojat e personave queer në marrjen e shërbimeve nga profesionistët e shëndetit mendor dhe punonjësit socialë. Ky dizajn u zgjodh për të mundësuar që pjesëmarrësit të shprehin në thellësi perspektivat dhe përvojat e tyre. Intervistat u realizuan duke u bazuar në një grup pyetjesh të përgatitura paraprakisht, të cilat ishin krijuar për të adresuar qëllimet e studimit. Një përmbledhje e temave kryesore të trajtuara në udhëzuesin e intervistave përfshin: Përvojat e pjesëmarrësve me profesionistët e shëndetit mendor dhe punonjësit socialë; Sfidat ose pengesat e perceptuara në qasjen në shërbime; Sugjerime për përmirësimin e shërbimeve.

Procedura

Intervistat u realizuan në dy mënyra, ballë për ballë dhe përmes telefonit, kjo për t'iu përshtatur nevojave të të intervistuarve. Ato u audio incizuan dhe më pas u transkriptuan. Para fillimit të intervistave u siguria që pjesëmarrësit janë të informuar për qëllimet e studimit, konfidencialitetin e intervistave dhe u siguruan që të dhënat e tyre do të përdoren vetëm për qëllime të hulumtimit.

Etika

Të gjithë pjesëmarrësit kanë plotësuar krieteret e përfshirjes, duke qenë mbi 18 vjet dhe duke pasur përvoja me profesionistët në marrjen e shërbimeve. Për më tepër, të intervistuarit ishin në dijeni që intervista po audio incizohej, se pjesëmarrja e tyre ishte vullnetare dhe se mund të tërhiqeshin në çdo moment në rast.

Të gjeturat

Në këtë studim janë identifikuar 6 kategori tematike:

1. Njohuri të pamjaftueshme mbi temat që lidhen me komunitetet queer dhe mungesë të kuptimit të thellë për përvojat e tyre

Njohuritë e pamjaftueshme dhe sipërfaqësore mbi temat që lidhen me komunitetet queer dhe mungesa e kuptimit të thellë për përvojat e tij janë çështje që ndikojnë në marrëdhënien mes individëve queer dhe profesionistëve të shëndetit mendor. Disa pjesëmarrës kanë pasur përvoja pozitive me profesionistët, ku këta të fundit kanë ofruar mbështetje, duke krijuar hapësirë për të diskutuar lirshëm për çështjet që i prekin. Por, gjithashtu, disa profesionistë kanë mungesë të njohurive të nevojshme për çështjet LGBTI+, çka shpesh çon në mungesë mbështetjeje dhe shpërfillje të nevojave të këtyre komuniteteve. Pjesëmarrësit e intervistave përshkruajnë se kur kanë folur për identitetin e tyre, kanë hasur në reagime të hutuar ose të pashpjegueshme nga profesionistët. Kjo mungesë e njohurive shpesh ka bërë që individët queer të ndjehen të lodhur dhe të detyruar të edukojnë profesionistët për çështjet që i prekin ata. Kjo nxjerr në pah nevojën për trajnime më të thelluara dhe më të fokusuara në çështjet LGBTI+ për profesionistët e shëndetit mendor dhe punëtorët socialë.

Përvoja ka qenë lloj-lloj. Disa herë kam ndje që më kuptojnë, po shumicën e herëve, sidomos kur e kam thanë që jam lezbike, ata kanë qenë të hutuar. Diqysh s'di. Nuk e kanë pasë shumë të qartë çka do me thonë kjo. Disa kanë pasur njohuri, disa s'kanë pasë kurrfarë ideje për këtë. Ndonjëherë kam mendu që nuk e di a është ky vendi për mu. Thojsha çka kanë

(A.F).

Vallahi, ka qenë mix. Disa psikologë kanë qenë shumë t'kuptueshëm, janë përpjekë. Disa prej tyre m'kanë dëgju edhe kanë qenë shumë mbështetës, po ka pasë raste kur e ndjeja që po e humbnin lidhjen ose nuk kishin njohuri t'mjaftueshme për temat LGBTI+. Dmth, ndonjëherë e kam pasë përshtypjen që kisha me ditë ma shumë unë për këto tema se sa ata. Për do, po, e për do jo. Ata që kanë qenë të informum, kanë bo shumë ndryshim. Tjera herë, ndjeja sikur isha unë që po i edukoja ata për temat queer. Dhe kjo është shumë e lodhshme kur je tu kërkju mbështetje (A.E).

2. Përvojat e pakënaqshme gjatë marrjes së shërbimeve të shëndetit mendor

Përjetimi i paragjykimeve dhe përdorimi i gjuhës diskriminuese gjatë marrjes së shërbimeve të shëndetit mendor është një çështje e rëndësishme që prek shumë individë queer. Komentet e gjykueshme dhe pyetjet që reflektojnë mungesë njohurie për komunitetet queer shpesh çojnë në ndjenja të turpfit dhe pakënaqësisë. Kjo sjellje mund të ndikojë në besimin e individëve ndaj profesionistëve dhe në ndjenjën e të qenit të respektuar në procesin e shërbimit. Megjithatë, disa individë kanë përjetuar mbështetje dhe trajtim me empati dhe respekt nga profesionistët, duke përforcuar hapjen dhe angazhimin e tyre në trajtim. Sidoqoftë, përvoja e keqkuptimit dhe stereotipizimit ka qenë gjithashtu e pranishme, veçanërisht kur janë lidhur komente të padëshiruara mbi pamjen ose sjelljet e individëve. Kjo mund të vërehet qartë në fragmentin e mëposhtëm:

Po, ka pasur raste që më janë dukë shumë gjykues. Ka pasë

raste kur një psikolog më ka thënë "edhe të tjerët kanë probleme, pse po më vjen kaq keq për ty?". Ti m'dhimbsesh mas se shumti. E kam ndje si faji im, si mos e vlerësojnë që po luftoj çdo ditë për identitetin tim, dhe kjo më ka lëndu (A.F).

Një herë, një psikolog m'tha diçka si: "A je i sigurt që nuk është vetëm një fazë?" E kuptoj që munden me dashtë me e kuptu situatën, po kur t'thojnë diçka të tillë, e kupton që nuk janë shumë të informum për komunitetin tonë. Ishte moment ku e humba pak besimin, se m'dukej sikur nuk e merrnin seriozisht identitetin tim (A.E).

Etika është çështje e rëndësishme në përvojat e individëve që kërkojnë mbështetje profesionale. Disa individë kanë pasur përvoja të këqija ku profesionistët kanë shfaqur sjellje të papranueshme dhe diskriminuese, duke përfshirë komente të pasjellshme dhe mungesë të respektit për privatësinë dhe kufijtë e klientëve. Këto sjellje kanë shkaktuar ndjenja të humbjes së besimit tek profesionistët. Në anën tjetër, disa individë kanë pasur përvoja ku profesionistët kanë respektuar privatësinë dhe kufijtë e tyre, duke ruajtur një nivel të lartë etik dhe profesionalizmi. Këta profesionistë kanë ofruar një ambient të sigurt dhe mbështetës, duke krijuar hapësirë për diskutimin e çështjeve të ndjeshme. Kjo sjellje ka përforcuar besimin e individëve tek profesionistët dhe ka kontribuar në ndjenjën e sigurisë dhe mbështetjes.

Sjellja e tyre ka qenë e papranueshme dhe joetike në shumë raste. Me pas ndodhë qetash e kisha denoncu qatherë e kom pranu. Qysh në fillim, ata mkanë trajtu me arrogancë dhe mungesë respekti. Komentet si "sillu ma burr" dhe "mos kaj si qik" janë jo vetëm të papërshtatshme, po edhe diskriminuese. Kjo sjellje ka treguqë ata nuk e kuptojnë rolin e tyre si profesionistë që duhet me qenë aty për me ofru ndihmë dhe mbështetje, jo për me i paragjyku njerëzit që kërkojnë ndihmë. Kjo eksperiencë ka pas shumë ndikim negativ te unë. Një prej problemeve kryesore që përjetova ishte mungesa e

privatësisë. Në vend që me diskutu rastin tim me konfidencialitet dhe seriozitet, krejt kati i qendrës për punë sociale e dinin për çka kisha ardhë. Kur po dilja prej zyrës, dëgjoja komente si "që ky djali që kajti si qik," dhe kjo më bënte me ndi shumë keq. Ktu ska pasë as konfidencialitet e as privatësi (A.A).

Psikologu im ka qenë shumë profesional dhe etik gjatë gjithë kohës. Gjithmonë respektonte kufijtë dhe e ka rujt konfidencialitetin. Kjo sjellje profesionale mka bo me u ndih shumë i sigurt duke folë sene shumë të ndjeshme me të (A.B).

She ghosted me pasi i thashë që po ndihesha suicidal, dhe kjo më duket si një praktikë joetike dhe e papërshtatshme. Nuk ishte mbështetje që prisja në një moment kaq të rëndësishëm...Po i respektoi kufijtë, privatësinë dhe konfidencialitetin tim (A.G).

3. Mentaliteti, qëndrimet dhe besimet në fokus: Implikimet për shërbimet e shëndetit mendor

Për shumë individë queer, sfidat kulturore dhe shoqërore shpesh nuk kuptohen nga profesionistët e shëndetit mendor. Pavarësisht nga përpjekjet për të ofruar mbështetje, disa profesionistë nuk janë të informuar mjaftueshëm për realitetin e jetës si queer në shoqërinë kosovare, ku ndikimi i mentalitetit tradicional dhe normave shoqërore mund të jetë i thellë. Kjo çon në vështirësi në kuptimin e sfidave që lidhen me identitetin dhe presionin shoqëror, veçanërisht në marrëdhëniet me familjen dhe shoqërinë.

Disa individë përjetojnë mbështetje dhe mirëkuptim nga profesionistët që janë të informuar dhe empatikë, por kjo nuk është gjithmonë rasti për të gjithë. Mendësia konservatore dhe qëndrimet e ndikura nga paragjykimet për komunitetet queer janë ende të pranishme te disa profesionistë. Këta individë mund të ofrojnë këshilla të bazuara në tradita të

vjetra dhe stereotipe, duke mos kuptuar plotësisht sfidat dhe nevojat e individëve queer. Ndaj, mbetet e rëndësishme që profesionistët e shëndetit mendor të jenë të trajnuar dhe të informuar për çështjet LGBTI+ për të ofruar shërbime të përshtatshme dhe mbështetëse. Kjo mund të vërehet në vijim:

Jo, shumicën e herëve nuk i kanë kuptu (sfidat kulturore dhe shoqërore). Mendoj se për shumë psikologë, si për shumë njerëz në Kosovë, ende është diçka e huaj, edhe pse na saher kena ekzistim. Ka pasë raste kur thjeshts'kanë ditë çka me thonë. Nuk e kuptojnë që është shumë ndryshe kur jeton si queer ktu, sidomos me familjen, e shoqërinë që janë shumë të ngarkuara me mentalitet të vjetër (A.F).

Po, shpesh e kam ndi atë ndjenjë (që nuk kuptohen sfidat kulturore e shoqërore). E di që nuk është gjithmonë faji i tyre, se është çështje e mos-informimit. Ama, kur dikush nuk e kupton presionin që ndjej kur jam me familjen, ose frikën prej asaj çka mund t'ndodhë nëse dal hapur, ndjehem i keqkuptim. Nuk e kanë gjithmonë idenë se sa t'vështirë e kemi me jetu n'këtë shoqni kur je queer (A.E).

Ata kishin një mendësi të ngushtë dhe të bazime krejt te traditat. Nuk i interesojke për çka ka shku aty personi. Ose ti je fajtorë ose kanë me të dhonë këshilla tradicionale në, josituatën reale që unë po përjetoja. Ishte shumë e qartë që nuk e kuptonin as identitetin tem, as sfidat me të cilat përballësia si person queer. Ishte shumë e qartë që ata nuk kishin asnjë njohuri ose trajnim për çështjet LGBTI+. Krejt këshillat që më jepnin ishtin te bazuar në tradita të vjetra dhe stereotipe të shoqnisë kosovare. Ata nuk dukeshin të interesuem për me e kuptu sfidat me të cilat përballen personat queer në Kosovë, Në vend që me konë të informum dhe mbështetës, ata po gjykonin dhe po përçmonin çdo aspekt (A.A).

4. Nevoja për trajnime dhe edukim më të thellë dhe gjithpërfshirës të profesionistëve

Mungesa e një kuptimi të thelluar për diversitetin gjinor dhe seksual ka çuar në një qasje të papërshtatshme dhe jo profesionale ndaj individëve queer. Shumë herë, shërbimet ofrohen në mënyrë të përgjithësuar, pa marrë parasysh ndjeshmërinë e situatës dhe pa u fokusuar në nevojat specifike të individëve të komuniteteve LGBTI+. Për pasojë, ndihma e ofruar shpesh ka qenë e pamjaftueshme dhe e paplotë, duke i lënë individët queer të ndihen të keqkuptuar dhe të papërkrahur. Përshtatja e shërbimeve të shëndetit mendor dhe trajnimi i profesionistëve në këto fusha janë thelbësore për të siguruar mbështetje të duhur dhe për të eliminuar barrierat që pengojnë individët queer të marrin shërbime adekuate.

5.1 Trajnimet e pamjaftueshme të profesionistëve të shëndetit mendor dhe punëtorëve social

Gjendja aktuale e situatës së profesionistëve të shëndetit mendor dhe punonjësve social ka treguar mungesë të mjaftueshme të trajnimit në lidhje me çështjet e komuniteteve LGBTI+. Kjo ka rezultuar në sjellje të papranueshme dhe diskriminuese nga ana e disa profesionistëve, të cilët nuk janë në gjendje të kuptojnë dhe mbështesin individët queer në mënyrën e duhur. Pa një trajnim adekuat, shumë profesionistë nuk mund të ofrojnë mbështetje të përshtatshme për të adresuar sfidat specifike që përjetojnë këta individë, duke u shfaqur si paragjykses dhe të painformuar në lidhje me situatat e tyre të veçanta.

Jo, nuk kishin fare trajnim të duhur. Sjellja e tyre tregonte mungesë totale të profesionalizmit dhe mirëkuptimit për çështjet LGBTI+. Nëse do të kishin marrë ndonjë trajnim për çështje të ndryshme që përjetojnë individët queer, nuk do të më trajtonin në atë mënyrë fyese dhe diskriminuese. Komentet e tyre si "a je çik a djal?" janë të papranueshme

për një profesionist. Punonjësit social duhet me qenë të trajnuar për me e kuptu diversitetin e njerëzve që i shërbejnë dhe me qenë në gjendje me ofru ndihmë të përshtatshme, e jo me i paragjyku dhe me i bullizu klientët e tyre (A.A).

Për disa prej tyre, po, ka qenë e qartë që e kanë pasë një mirëkuptim të fortë dhe janë përpjekë me ofru mbështetje në mënyrë efektive. Por ka edhe profesionistë që ndoshta nuk kanë pasë trajnim të mjaftueshëm për t'u marrë me çështjet specifike të komuniteteve LGBTI+ (A.D).

S'besoj që krejt kanë trajnim t'mjaftueshëm. Disa ndoshta kanë bo ndonjë kurs të përgjithshëm, po çështjet që na përjetojmë janë shumë specifike dhe kërkojnë ma shumë njohuri. Nuk është veç çështje se a ke mësu për LGBTI+, po a e di çka dmth me qenë queer n'Kosovë (A.E).

5.2 Sygjerime per rritjen e kompetencave te profesionisteve

Për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për komunitetet LGBTI+, është thelbësore që profesionistët e shëndetit mendor dhe punonjësit social të kalojnë trajnime të specializuara që i pajisin ata me njohuri të thelluara mbi diversitetin dhe sfidat specifike të individëve queer. Kjo përfshin trajnime që adresojnë ndjeshmërinë kulturore, diskriminimin dhe nevojat e veçanta të këtyre komuniteteve. Aktivitetet si workshop-et dhe diskutimet ndërmjet profesionistëve dhe komuniteteve mund të rrisin kuptimin dhe mbështetjen efektive. Gjithashtu, shërbimet duhet të jenë të aksesueshme dhe të përballueshme, duke garantuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e privatësisë. Kjo do të krijonte një ambient të sigurt dhe mbështetës për individët queer.

Së pari, duhet të ketë më shumë trajnim dhe edukim për çështjet LGBTI+. Psikologët dhe punonjësit social duhet me pasë njohuri për diversitetin dhe për sfidat që përjetojnë personat queer. Po ashtu, duhet të me kon diçka që garanton

konfidencialitet dhe privatësi për klientët, sepse kjo është jetike për me kriju një ambient të sigurt. Ata duhet me i lonë këshillat tradicionale dhe paragjykimet dhe mu fokusu në mbështetjen individuale, duke dëgjuar dhe tu l marrë për baz eksperiencat e tij (A.A).

Mendoj që ma shumë psikologë duhet me pas trajnime specifike për çështjet LGBTI+ që me përmirësu qasjen që e kanë me pjestarë të komuniteteve. Po ashtu, do të ishte mirë me pas qasje ma të lirë dhe ma të përballueshme në këto shërbime, sepse për shumë njerëz, qasja financiare osht një problem i madh. Konfidencialiteti gjithashtu duhet me qenë gjithmonë n'vend të parë, e njerëzit duhet me u ndje të sigurt që informacionet e tyre janë të mbrojtuna (A.C).

Barrierat në marrjen e shërbimeve efektive të shëndetit mendor

5. Barrierat kryesore që pengojnë individët queer në marrjen e shërbimeve efektive të shëndetit mendor përfshijnë mungesën e edukatës dhe trajnimeve të duhur për çështjet LGBTI+, paragjykimet dhe homofobinë/transfobinë nga profesionistët. Shpesh, psikologët dhe punonjësit socialë nuk janë të përgatitur të kuptojnë sfidat specifike të individëve queer, për shkak të njohurive të vjetra dhe ndikimit të normave tradicionale. Mungesa e besimit, stigmës shoqërore dhe barrierave financiare gjithashtu ndihmojnë në pengimin e aksesit në shërbime, duke krijuar një ndjenjë pasigurie dhe hezitim për të kërkuar ndihmë. Për më tepër, mungesa e legjislacionit që mbron personat LGBTI+ nga diskriminimi në shëndetësi dhe shërbimet sociale rrit sfidat për këta individë. Kjo mund të vërehet qartë në vijim:

Barriera kryesore për menimin tem injoranca, mungesa e edukatës për çështje LGBTI+, dhe paragjykimet që kanë shumë punonjës socialë dhe psikologë. Shumë prej tyre s'dinë as çfarë është ndjenja të jetosh si queer në një shoqëri si kjo, e kaniherë më dokët që as nuk dojnë me ditë shumë

mendjembyllur në këtë aspekt (A.F).

Konfidencialiteti, besoj oshtë kryesore. Një prej barrierave kryesore oshtë stigma shoqërore që i mban individët queer larg kërkimit të ndihmës profesionale. Shumë persona hezitojnë me shku te psikologu ose punëtori social prej frikës se identiteti i tyre mund të zbulohet, ose prej mosbesimit që të tjerët do ta mbajnë sekret. Një tjetër problem oshtë qasja financiare. Shërbimet e shëndetit mendor dhe sociale shpesh nuk janë të përballeshme për të gjithë, sidomos për të rinjtë që nuk kanë të ardhura. Përveç kësaj, ka shumë pak psikologë ose punëtorë socialë që janë të njohur për mbështetjen e komuniteteve LGBTI+, dhe kjo krijon një ndjenjë pasigurie për ata që kërkojnë ndihmë (A.C).

6. Sygjerime për burime, mbështetje dhe qasje gjithëpërfshirëse

Për të përmirësuar mbështetjen për komunitetet queer në Kosovë, është e nevojshme krijimi i hapësirave të sigurt ku individët mund të shprehin veten pa frikën e paragjykimeve. Krijimi i qendrave mbështetëse specifike për këtë komunitet, ku individët mund të kërkojnë ndihmë pa pasur shqetësime për diskriminim, është një hap i rëndësishëm. Këto hapësira duhet të ofrojnë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve sociale dhe mbështetje psikologjike. Poashtu duhet bërë rritja e mundësive për trajnim të profesionistëve të shëndetit mendor dhe punonjësve socialë, për të siguruar që ata të jenë të përgatitur për të kuptuar dhe adresuar nevojat e komuniteteve përfshirë trajtimin e specifikave të individëve trans dhe queer.

Do të dëshiroja që të kishim më shumë hapësira queer ku mundemi me qenë vetvetja pa u tutë prej gjykimeve. Edhe pse kemi disa vende si Bubble Bar, mendoj që nuk mjaftojnë. Hapësira të sigurt, të dedikuara për komunitetet LGBTI+, ku mundemi me folë, me kriju shoqni, dhe me organizu aktivitete

do të ishin shumë mirë. Hapsira që të jemi të lirë dhe të jemi kush jemi pa u mshefë (A.D).

Do të ishte mirë që të kishte më shumë qendra mbështetëse specifike për komunitetet LGBTI+ në Kosovë, ku mund të shkojmë pa frikë dhe pa paragjykime. Po ashtu, do të ishte shumë e dobishme me pasë psikologë dhe punonjës social që janë të trajnuar për me punu me individët queer dhe që e kuptojnë thellësisht çka do të thotë me përjetu diskriminim për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (A.A).

Më kish pëlqy me pasë një grup mbështetje ku mundem me taku njerëz tjerë që janë tu përjetu gjëra të ngjashme si unë. Me pasë dikë që t'kupton prej përvojës së vet, është një ndihmë e madhe. Edhe, ndonjë linjë telefonike veç për komunitetet queer, ku mundemi me marrë këshilla anonime e pa u tutë (A.E).

Diskutimi

Ky studim shyrtoi përvojat e individëve queer në Kosovë me psikologë dhe punëtorë social. Në kontekstin e këtij hulumtimi, u zbulua se individët queer përballen me sfida të shumta, të cilat janë të vështira për t'u përballuar. Bazuar në përvojat dhe perceptimet e pjesëmarrësve në këtë studim, u vërejtën disa barrierë dhe faktorë lehtësues që mund të ndikojnë në kërkimin e ndihmës. Disa prej këtyre barrierave siç janë frika nga diskriminimi ose qasja në shërbime të specializuara për çështje që lidhen me komunitetet LGBTI+. Këto sfida i çojnë individët në kriza të shëndetit mendor dhe mungesë të pranimit social.

Sfidat me të cilat ballafaqohen individët zakonisht përfshijnë: homofobinë, shkeljen e të drejtave të njeriut, diskriminimin, stigmën sociale si dhe përjashtimin social. Këto sfida lidhen si me mungesën e trajnimit specifik për profesionistët, ashtu edhe me paragjykimet e rrënjësura thellë në shoqëri. Si rezultat, këto faktorë ndikojnë në gatishmërinë e individëve queer për të kërkuar ndihmë profesionale. Studimet ndërkombëtare kanë treguar se ndjeshmëria ndaj identitetit dhe përvojave të individëve queer është thelbësore për ndërtimin e marrëdhënieve efektive terapeutike (Dotan, 2024). Shoqata Amerikane e Psikologjisë (APA, 2019) thekson rëndësinë e një qasjeje afirmative dhe mbështetëse ndaj klientëve LGBTQ+, duke nënvizuar se kjo qasje jo vetëm që ndihmon në krijimin e një ambienti të sigurt dhe mirëkuptues, por gjithashtu rrit rezultatet pozitive të terapisë për këtë grup klientësh. Në mënyrë të veçantë, profesionistët e shëndetit mendor inkurajohen të kuptojnë sfidat unike me të cilat përballen komunitetet queer, për të ndërtuar raporte të forta dhe për të

përmirësuar mirëqenien e tyre mendore dhe emocionale” (APA, 2024).

Në Kosovë, kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh kontekstin kulturor dhe stigmatizimin shoqëror, që i vendos individët queer në pozita të margjinalizuara dhe shtypëse. Një tjetër element për tu diskutuar është etika dhe respektimi i kufijve personalë dhe konfidencialitetit. Individët queer janë shumë të ndjeshëm ndaj çështjeve të konfidencialitetit, pasi shkeljet në këtë aspekt mund të kenë pasoja të rënda për ta, veçanërisht në një shoqëri ku diskriminimi është ende i përhapur. Sipas National Cybersecurity Alliance (2021), komprometimi i privatësisë mund të çojë në humbjen e punës, prishjen e marrëdhënieve familjare dhe përkeqësimin e mirëqenies fizike dhe emocionale. Mungesa e mbrojtjes së informacionit personal mund të shkaktojë diskriminim të mëtejshëm, veçanërisht në epokën dixhitale ku ndarja e të dhënave është më e ndjeshme dhe e gjerë (National Cybersecurity Alliance, 2021).

Të intervistuarit kanë ndarë disa përvoja pozitive në raport me psikologët dhe punëtorët socialë, duke përmendur raste kur janë ndjerë të dëgjuar dhe të mbështetur nga profesionistë të caktuar që kanë treguar empati dhe profesionalizëm. Megjithatë, ata theksuan se këto përvoja pozitive nuk kanë qenë universale, pasi jo të gjithë profesionistët janë treguar mbështetës në të njëjtën mënyrë. Sfida kryesore për krijimin e një ambienti të shëndetshëm ishte garantimi i privatësisë dhe konfidencialitetit për të intervistuarit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur ofrohen shërbime psikosociale, pasi mungesa e besimit në mbrojtjen e të dhënave personale mund të pengojë individët të kërkojnë ndihmë, të ndajnë hapur përvojat e tyre dhe të përfitojnë nga mbështetja profesionale. Në mungesë të mbrojtjes së garantuar të privatësisë, antarët e këtyre

komuniteteve shpesh hezitojnë të kërkojnë shërbime për shëndetin mendor, duke e thëlluar izolimin dhe duke ndikuar negativisht në mirëqenien e tyre (Bengtsson-Tops et al., 2021; Cambridge Core, 2023).

Hulumtimi vë në pah paragjykimet e pranishme në nivele të ndryshme të shoqërisë, duke filluar nga shoqëria e gjerë deri te profesionet e specializuara, si psikologjia dhe puna sociale. Këto sfida janë theksuar nga personat e intervistuar dhe lidhen me ndikime që burojnë nga jashtë, si nga normat shoqërore dhe kulturore dhe ndikimet që ato mund të kenë në formësimin e përvojave të tyre. Është e rëndësishme të theksohet se tensionet që individët përjetojnë pasqyrojnë presionet e jashtme si normat dhe pritshmëritë kulturore, të cilat mund të ndikojnë në mirëqenien psikologjike. Në vend që të trajtohen si çështje individuale, këto sfida duhet të konsiderohen si pasqyrime të ndikimeve nga ambienti shoqëror dhe kulturor ku individët jetojnë (Meyer, 2015; Frost & Meyer, 2019).

Të intervistuarit kanë treguar se janë përballur me barriera në institucione shtetërore, në shoqëri dhe në jetën e tyre të përditshme. Këto barriera lidhen drejtpërdrejt me çështjet LGBT+, duke përfshirë frikën nga diskriminimi, shqetësimet për ruajtjen e konfidencialitetit përvojat negative me profesionistët, mungesën e shërbimeve të specializuara dhe koston e lartë të tyre. Ata shprehën hapur se shpesh janë ndjerë të gjykuar nga rrethi dhe familja, duke përjetuar stigmatizim dhe përjashtim social. Përvojat e tyre ilustrojnë qartë diskriminimin e përhershëm që komunitetet LGBTI+ përjetojnë në përditshmëri, duke përfshirë trajtime të pabarabarta dhe mungesë mbështetjeje në mjediset sociale dhe institucionale. Për shembull, një analizë globale e periudhës së pandemisë COVID-19 ka theksuar se komunitetet LGBTI+ kanë përjetuar intensifikim të diskriminimit, duke u bërë më e vështirë qasja në shërbime

dhe mbështetje të nevojshme (BMJ Global Health, 2021). Këto përvoja të diskriminimit janë shpesh të lidhura me faktorë shoqërorë dhe institucionalë që vazhdojnë të mbështesin një mjedis të pasigurt për individët LGBTI+ (Frost & Meyer, 2019).

Kufizimet

Një ndër kufizimet e këtij studimi është se disa nga të intervistuarit ishin përfitues të të njëjtave burime të shërbime psikosociale, gjë që mund të ketë ndikuar në ngjashmërinë e përvojave dhe përgjigjeve të tyre. Kjo mund të ketë kufizuar diversitetin e perspektivave të përfshira në analizë dhe të ketë krijuar një pamje më të kufizuar të sfidave, nevojave të tyre dhe përvojave pozitive me profesionistët, të cilët mund të mos jenë reprezentiv me profesionistët e tjerë Kosovar. Poashtu, kufizim tjetër ishte se vetëm disa nga të intervistuarit kishin pasur përvojë me punëtorë social. Poashtu, mostra e limituar e studimit e cila mund të mos përfaqësojë plotësisht përvojën e gjithë personave queer.

Rekomandime

Rekomandohet realizimi i studimeve të mëtejshme që kontrollojnë variablat e mundshëm, siç është moshë e profesionistëve, niveli i edukimit (përvojat akademike brenda ose jashtë vendit), pjesëmarrja në trajnimet për çështjet queer, dhe faktorët e tjerë që mund të ndikojnë në ndryshimet që shihen në rezultatet e ndryshme të ofruara nga profesionistët. Kjo do të ndihmonte në kuptimin e faktorëve që kontribuojnë në eksperiencat pozitive dhe negative të individëve queer me profesionistët e shëndetit mendor dhe punonjësit socialë. Sigurimi i më shumë burimeve dhe trajnimeve për psikologët dhe punëtorët socialë është thelbësor për të përmirësuar kompetencat e tyre në punën me komunitetet LGBTI+. Rekomandohet të krijohen programe të rregullta të edukimit dhe trajnimeve që

përfshijnë tema të diversitetit gjinor, identitetit seksual, dhe përvojave të komuniteteve queer. Gjithashtu, është e rëndësishme të punohet për të krijuar një atmosferë më të besueshme dhe më të mirëkuptueshme për klientët queer, duke siguruar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e informacionit personal gjatë shërbimeve profesionale. Përveç kësaj, duhet të punojmë për të rritur aksesin financiar të këtyre shërbimeve për individët që përballen me barrierat financiare.

Referencat

American Psychological Association. (2019). CE corner: The key to healthy relationships. *Monitor on Psychology*, 50 (11). <https://www.apa.org/monitor/2019/11/ce-corner-relationships>

APA PsycNet. (n.d.). <https://psycnet.apa.org/buy/2008-07318-015>

Bengtsson-Tops, A., & Hansson, L. (2021). Importance of trust in mental health care. *Cambridge Core*.

BMJ Global Health. (2021). *Impact of COVID-19 on the LGBTI+ community*. *BMJ Global Health*, 6(7), e005933. <https://doi.org/10.1136/bmjgh-2021-005933>

Cambridge Core. (2023). Confidentiality and security in mental health services.

Choukas-Bradley, S., & Thoma, B. C. (2022). Mental health among LGBT youth. *In Focus on sexuality research* (pp. 539–565). https://doi.org/10.1007/978-3-030-84273-4_18

Craig, S. L., Dentato, M. P., Messinger, L., & McInroy, L. B. (2014). Educational Determinants of Readiness to Practise with LGBTQ Clients: Social Work Students Speak Out. *The British Journal of Social Work*, 46(1), 115–134. <https://doi.org/10.1093/bjsw/bcu107>

Cruciani, G., Quintigliano, M., Mezzalana, S., Scandurra, C., Carone, N. (2024) Attitudes and Knowledge of Mental Health Practitioners towards LGBTQ+ Patients: A Mixed-

method Systematic review.. Elsevier, 113. <https://doi.org/10.1016/j.cpr.2024.102488>

Dentato, M. P., Kelly, B. L., Lloyd, M. R., & Busch, N. (2017). Preparing social workers for practice with LGBT populations affected by substance use: perceptions from students, alumni, and service providers. *Social Work Education*, 37(3), 294–314. <https://doi.org/10.1080/02615479.2017.1406467>

Dotan, L. (2024, April 25). *Mental health counseling: Specialization in drama therapy* (Master's thesis, Lesley University). Lesley University Digital Commons. https://digitalcommons.lesley.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1820&context=expressive_theses

Frost, D. M., & Meyer, I. H. (2019). *Internalized discrimination and the mental health of LGB individuals*. In *The Oxford Handbook of Stigma, Discrimination, and Health* (pp. 289–309). Oxford University Press.

Frost, D. M., & Meyer, I. H. (2019). Internalized stigma and minority stress: A dynamic, multilevel framework for LGBTQ health. *Social Science & Medicine*, 232, 198–206. <https://doi.org/10.1016/j.socscimed.2019.04.019>

Gnan, G. H., Rahman, Q., Ussher, G., Baker, D., West, E., & Rimes, K. A. (2019). General and LGBTQ-specific factors associated with mental health and suicide risk among LGBTQ students. *Journal of Youth Studies*, 22(10), 1393–1408. <https://doi.org/10.1080/13676261.2019.1581361>

Lennon-Dearing, R., & Delavega, E. (2015). Policies discriminatory of the LGBT community: Do social workers endorse respect for the NASWCode of Ethics? *Journal of Gay & Lesbi-*

an *Social Services*, 27(4), 412–435. <https://doi.org/10.1080/10538720.2015.1087266>

McCann, E., & Sharek, D. (2013). Survey of lesbian, gay, bisexual, and transgender people's experiences of mental health services in Ireland. *International Journal of Mental Health Nursing*, 23(2), 118–127. <https://doi.org/10.1111/inm.12018>

Meyer, I. H. (2015). Resilience in the study of minority stress and health of sexual and gender minorities. *Psychology of Sexual Orientation and Gender Diversity*, 2(3), 209–213. <https://doi.org/10.1037/sgd0000132>

National Cybersecurity Alliance. (2021). *Data privacy is crucial for the LGBT community*. Retrieved November 19, 2024, from <https://staysafeonline.org>

Ojeda-Leitner, D., & Lewis, R. K. (2019). Assessing health-related stereotype threats and mental healthcare experiences among a LGBT sample. *Journal of Prevention & Intervention in the Community*, 49(3), 251–265. <https://doi.org/10.1080/10852352.2019.1654262>

Rees, S. N., Crowe, M., & Harris, S. (2020). The lesbian, gay, bisexual and transgender communities' mental health care needs and experiences of mental health services: An integrative review of qualitative studies. *Journal of Psychiatric and Mental Health Nursing*, 28(4), 578–589. <https://doi.org/10.1111/jpm.12720>

Ross, L. E., Gibson, M. F., Daley, A., Steele, L. S., & Williams, C. C. (2018). In spite of the system: A qualitatively-driven mixed methods analysis of the mental health services experiences of LGBTQ people living in poverty in Ontario, Canada. *PLoS*

ONE, 13(8), e0201437. <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0201437>

Rossman, K., Salamanca, P., & Macapagal, K. (2017). A qualitative study examining young adults' experiences of disclosure and nondisclosure of LGBTQ identity to health care providers. *Journal of Homosexuality*, 64(10), 1390–1410. <https://doi.org/10.1080/00918369.2017.1321379>

Russell, S. T., & Fish, J. N. (2016). Mental health in lesbian, gay, bisexual, and transgender (LGBT) youth. *Annual Review of Clinical Psychology*, 12(1), 465–487. <https://doi.org/10.1146/annurev-clinpsy-021815-093153>

Russell, G. M., & Bohan, J. S. (2006). The case of internalized homophobia: Theory and/as practice. *Theory & Psychology*, 16(3), 343–366. <https://doi.org/10.1177/0959354306064279>

Smith, R. W., Altman, J. K., Meeks, S., & Hinrichs, K. L. (2018). Mental Health Care for LGBT Older Adults in Long-Term Care Settings: Competency, training, and Barriers for Mental health providers. *Clinical Gerontologist*, 42(2), 198–203. <https://doi.org/10.1080/07317115.2018.1485197>

Snapp, S. D., Hoenig, J., Fields, B., & Eckard, C. (2015). Supporting LGBTQ students: The importance of safe spaces in schools. *Journal of Adolescent Health*, 57(6), 1–9. <https://doi.org/10.1016/j.jadohealth.2015.07.016>

Steele, L. S., Daley, A., Curling, D., Gibson, M. F., Green, D. C., Williams, C. C., & Ross, L. E. (2016). LGBT identity, untreated depression, and unmet need for mental health services by sexual minority women and Trans-Identified people. *Journal of Women's Health*, 26(2), 116–127. <https://doi.org/10.1089/jwh.2015.5677>